

FJALA E DEPUTETES MIRELA PITUSHI

E HËNË 20 DHJETOR 2021

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Te dashur qytetarë,

Të gjithë jemi dëshmitarë të historive të trishtueshme, që kanë qenë dhe janë të lidhura me fatet e jetëve të fëmijëve, prindërit e të cilëve kanë humbur jetë, si në kushtet e përcaktuara nga ligji “Për statusin “Dëshmor i Atdheut””. Sot ne shqyrtojmë projektligjin për statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, për përcaktimin e kriterëve dhe procedurës për përfitimin e statusit, si dhe i të drejtave e përfitimeve që rrjedhin nga ky status. Problemet për të cilat propozohet ky projektligj janë: së pari, mungesa e një ligji të dedikuar për përfitimet e fëmijëve të personave që u është dhënë statusi “Dëshmor i Atdheut”; së dyti, nga legjislacioni aktual nuk parashikohet mbështetja ekonomike për fëmijët e personave të cilëve u është dhënë statusi “Dëshmor i Atdheut”. Për shkak të problemit të konstatuar dhe të shkaqeve që sjellin ekzistencën e tij është vendosur që të ndërmerren hapa konkretë për ndryshimin e politikës së ndjekur deri tani dhe zgjerimin e rolit të shtetit, si mbrojtës i mirëqenies sociale në zbatim të detyrimeve kushtetuese. Me anë të parashikimeve të këtij projektligji përfitohen disa lloje trajtimesh financiare dhe jomateriale. Në këtë drejtim, pa hezituar mund të them se qeveria shqiptare, Këshilli i Ministrave, por edhe më gjerë janë treguar shumë të ndjeshëm në marrjen e përgjegjësisë ligjore shtetërore, me qëllim lehtësimin e problematikës së fëmijëve që kanë pësuar trauma familjare në humbje të njërit ose të të dy prindërve. Nëse do t’u referohemi politikave sociale të ndërmarra dhe të prezantuara gjatë miratimit të buxhetit të vitit të ardhshëm, bie në sy fakti që është rritur edhe më shumë vëmendja, kujdesi dhe shkalla e përfitimit financiar të kësaj kategorie. Në këtë projektligj nuk kemi trajtim të fëmijëve në status jetimi, por përfituesit janë fëmijët ose personat nën kujdestari të shtetasve shqiptarë, të cilët kanë humbur jetën qoftë edhe për shkak të plagëve të marra në përpjekje për të ndihmuar popullsinë në mbrojtje të pronës publike ose për shpëtimin dhe mbrojtjen e jetëve të individit, si rezultat i një akti vetëmohimi ose patriotizmi.

Një tjetër kategori përfituesish janë edhe fëmijët ose personat në kujdestari të shtetasve shqiptarë që kanë humbur jetën, qoftë edhe për shkak të plagëve ose të sëmundjeve të marra si pasojë e kryerjes me përgjegjësi të funksionit ose detyrës publike në kushte ose situata që lidhen me ngjarje të jashtëzakonshme ose të fatkeqësive natyrore. Sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, si për marrjen edhe për humbjen ose përjashtimin nga statusi “Fëmijë në përkujdesjen të Republikës” është përcaktuar qartësisht në disa drejtime. Tashmë të gjithë e kemi të qartë që përmbajtja e këtij ligji na mundëson përcaktimin e kriterëve tejte të qarta dhe të procedurës për përfitimin e këtij statusi, si dhe të drejtave dhe përfitimeve që rrjedhin nga ky status. Ky ligj garanton mirëqenien dhe zhvillimin e jetës së fëmijës nëpërmjet ndihmës dhe përkujdesjes efektive të shtetit, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Nëse do të ndalemi në një moment të veçantë te subjektet që janë të ngarkuara dhe të interesuara për ndjekjen dhe zbatimin e këtij ligji, interesi shfaqet nga vetë familjarët e tyre, organet e pushtetit qendror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore që ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e

detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj. Statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” përfitohet deri në moshën 18 vjeç dhe i siguron personit një trajtim të veçantë material dhe moral, sipas parashikimeve të këtij ligji, deri në moshën 25 vjeç, nëse ndjek arsimin e lartë. Pas kësaj moshe, statusi ruhet gjatë të gjithë jetës, por nuk të jep të drejtë për trajtim të veçantë material përveç shoqërimit, nderimit dhe përkujdesjes morale nga organet publike përkatëse, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji. Në këtë projektligj janë të saktësuara tepër qartë se çfarë përfitimesh gëzon fëmija nga statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”.

Ai përfiton trajtim financiar mujor, që llogaritet në bazë të pagës mujore më të lartë të prindit ose kujdestarit ligjor që ka humbur jetën, pavarësisht nga perioda e sigurimit të të ndjerit, përkatësisht në masën 100% për çdo fëmijë, kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën ka vetëm një fëmijë që gëzon statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, 70% për çdo fëmijë kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën ka dy fëmijë që gëzojnë këtë status, 50% për çdo fëmijë kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën ka 3 fëmijë që gëzojnë këtë status, 40% për çdo fëmijë, kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën ka 4 fëmijë që gëzojnë këtë status, 30% për çdo fëmijë, kur në ngarkim të personi që ka humbur jetën ka më shumë se 4 fëmijë që gëzojnë këtë status. Në këtë rast trajtimi financiar mujor për të gjithë fëmijët përfitues të mos tejkalojë shumën 150% të pagës më të lartë të prindit ose kujdestarit ligjor që ka humbur jetën. Në rast se përfitojnë trajtim financiar sipas ligjeve të tjera, ka të drejtë të zgjedhë trajtimin financiar më të favorshëm. Pagesa e trajtimit financiar sipas kësaj pike do të kryhet nga ISSHja.

Pra, të nderuar kolegë, përmes kësaj nisme të re të qeverisë, e cila parashikon se fëmijët e personave, që marrin statusin e “Dëshmorit të Atdheut”, do të kenë një përkujdesje sociale shtesë nga shteti që fillon që nga një trajtim financiar, shërbim shëndetësor falas e deri tek arsimimi i plotë falas në të tria ciklet. Ai synon të garantojë mirëqenien dhe zhvillimin e jetës së fëmijës, nëpërmjet ndihmës dhe përkujdesjes efektive të shtetit. Ky trajtim do të jetë deri në moshën 25-vjeçare nëse fëmija vendos të ndjekë studimet e larta. Marrja e këtij statusi krijon edhe disa detyrime honorifike ndaj fëmijëve të dëshmorëve të atdheut. Në këtë kuadër, synohet të përkujtojmë sakrificën dhe vetëmohimin e prindërve të tyre në kuadër të një ceremonie nën përgjegjësinë e organeve publike qendrore dhe lokale. Të organizohen në ente, shoqata, institute dhe fondacione jofitimprurëse, me synim vlerësimin e sakrificës dhe vetëmohimin e prindërve dhe dhënien e shembullit të brezave që të bëhen pjesë të ceremonive dhe organizimeve madhore me rastin e festave kombëtare dhe atyre zyrtare. Faleminderit!